



Presidenti i FSHF-se Armand Duka është shprehur Ekskluzivisht për Albaniasoccer.com se ai pret të takohet me trajnerin aktual të kombetares se Shqipërisë ditën e hënë për të rinovuar kontratën e re që do të zgjasi deri në përfundim të eliminatoreve të Kampionatit Evropian France 2016.

“Nuk e kam takuar akoma ‘Misterin’ “, u shpreh Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit Armand Duka për Albaniasoccer.com.

“Besoj se do të takohemi ditën e hënë dhe do të mbyllim gjithçka. Une besoj se nuk kemi asnjë problem që mund të na pengojë rinovimin. Jam i predisponuar që ta rinovoj kontratën dhe ta mbaj trajnerin perseri në krye të skuadres. Vullnetin e kam pozitiv dhe shpresoj se gjithçka do të përfundojë me sukses që ta vazhdojmë bashkëpunimin me ‘Misterin’ “, përfundoi Armand Duka prononcimin e tij për Albaniasoccer.com

Puna dedikuese që trajneri Italian ka zhvilluar me skuadrën kombëtare, afrimi në ekip i shumë talentëve nga diaspora si dhe projektplanin e tij për një të ardhme më të suksesshme për kombëtaren e Shqipërisë kanë qenë disa nga pikat kryesore që e kanë motivuar Presidentin e FSHF-se që të ketë një predispozim pozitiv për të rinovuar me De Biasin, ndonëse në dy ndeshjet e fundit rezultatet dhe taktika e ndjekur nga trajneri Italian nuk ishin me të mirat.

Trajneri Italian ndodhet në Shqipëri dhe ashtu si Duka pret që të përmbylli gjithçka rreth kontratës së re pozitivisht dhe pa kontradiktë pasi të dyja palët duken shumë konfidente për rinovimin.